

**REKOMANDIME NGA KONFERENCA SHKENCORE**  
***TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE – RISI E SHKENCËS GJEOGRAFIKE SHQIPTARE***

Për trashëgiminë tonë natyrore dhe kulturore janë shënuar arritje jo të vogla. Njëherazi janë të shumta problemet, rreziqet, dëmtimet e mëdha dhe sfidat në zonat e mbrojtura, për zgjidhjen e të cilave konferenca rekomandoi se:

- Studimi, ruajtja dhe menaxhimi shkencor i trashëgimisë sonë natyrore duhet të radhitet në prioritetet kombëtare të vendit.
- Trajtimi dhe menaxhimi i trashëgimisë sonë duhet të mbështetet në studime të thelluara shumëdisiplinore: nga shkencat natyrore (biologjike, e pylltarisë, gjeografike, gjeologjike etj.) dhe nga shkencat humane (sociologjike, ekonomike, politike etj.).
- Studimet gjeografike dhe të studiuesve të kulturës duhet të përqendrohen në njohjen e kushteve natyrore, sociale dhe ekonomike të zonave të mbrojtura, që përcaktojnë biodiversitetin e gjendjen e tij dhe dukuri, vlera dhe objekte unike të tjera natyrore; në njohjen e vlerave, siteve dhe monumenteve kulturore, që ndodhen në territorin e zonave të mbrojtura; në njohjen e lidhjeve shpirtërore të banorëve me objekte e vlera të veçanta, unike natyrore të zonave të mbrojtura.
- Studimet e trashëgimisë duhet të gjejnë format dhe rrugët e përballimit të pasojave negative mjedisore, sidomos për sitet dhe vlerat e trashëgimisë, të zhvillimeve të fundit në botë dhe në Shqipëri: globalizmi; urbanizimi galopant dhe shpesh kaotik; probleme shumë të mprehta mjedisore (ngrohja globale e klimës, ndotja, shkretëtirëzimi, humbja e pakthyeshme e biodiversitetit etj.); zhvillimi i shpejtë i turizmit etj.
- Studimet e trashëgimisë duhet të synojnë shtimin e sipërfaqes së mbrojtur të vendit tonë, duke evidentuar të gjitha sitet, objektet dhe dukuritë e rralla, unike të vendit me larmi të theksuar natyrore, që e bëjnë atë një muze të vërtetë natyror. Me prioritet duhet parë studimi dhe propozimi i siteve tona natyrore për statusin e trashëgimisë botërore.
- Krahas arritjeve, duhet forcuar më tej mbështetja ligjore dhe institucionore; bashkëpunimi i të gjithëve në mbrojtjen dhe menaxhimin shkencor të trashëgimisë sonë.
- Të përfitohet nga përvoja botërore për përgatitjen e strategjive të rritjes së sipërfaqes së zonave të mbrojtura, për aplikimin e koncepteve të reja në ruajtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin shkencor të vlerave të trashëgimisë për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe sidomos të turizmit.
- Rritja e sipërfaqes së mbrojtur, aktualisht rreth 16%, shumë shpejt rreth 20% të vendit, ka nxjerrë urgjencën e përgatitjes së studiuesve, të specialistëve dhe të menaxhuesve të aftë të trashëgimisë sonë natyrore. Kjo kërkon përgatitjen dhe zbatimin e një strategjie kombëtare që të përfshijë organet e arsimit dhe edukimit, mjedisit, turizmit, kualifikimit dhe punësimit etj. Për këtë qëllim universitetet tona duhet të bëhen pjesë e FUUT-it (Forumi UNESCO, Universitet, Trashëgimi), e programeve të tij dhe të Qendrës Botërore të Trashëgimisë. Duke u mbështetur në përvojën dhe në arritjet e tyre, të thellohet dhe të përmirësohet risia e kurrikulës së gjeografisë sonë shkollë, duke e rritur më tej shtrirjen dhe përmbajtjen e lëndës së trashëgimisë në arsimin parauniversitar e universitar dhe duke hapur mastera e drejtime të reja të shkollës së doktoratës me objekt trashëgiminë.

- Të zbatohen kriteret, kërkesat dhe udhëzimet e Konventës së Trashëgimisë Botërore për sitet shqiptare në listën e kësaj konvente dhe të Konventës Ramsar për ligatinat tona të regjistruara në listën e saj; të njihet dhe të aplikohet përvoja botërore në menaxhimin e siteve tona në rrjetin EMERALDE, në rrjetin e Parqeve të Harkut Dinarik dhe të Zonave të Mbrojtura Detare të Mesdheut. Vëmendje t'i kushtohet menaxhimit, sipas përvojës europiane, të sektorit tonë të Brezit të Gjelbër European; thellimit të studimeve shumëdisiplinore për të realizuar kërkesat e Projektit 'Natyra 2000', i filluar për 5 zona të mbrojtura të Shqipërisë.

- Të vazhdojë dhe të shpejtohet eksplorimi i shpellave karstike, me vlera të mëdha shkencore, turistike, kulturore, didaktike. Të gjendet mundësia e financimit të projektit të filluar për kthimin e Shpellës së Zezë në muze të vizitueshëm dhe shtrirjen e këtij projekti drejt parkut turistik të Pëllumbasit dhe Shëngjergjit; të përgatiten projekte për kthimin e shpellave të tjera në të vizitueshme.

- Të njihen dhe të respektohen vlerat e mëdha të traditës së pasur materiale dhe shpirtërore të popullsisë në sitet e trashëgimisë sonë natyrore. Të evitohet shkelja dhe dëmtimi i saj nga aktivitetet brutale, sidomos nga ndërtimet jashtë kësaj tradite (arkitektura e ndërtimeve apo e rehabilitimeve, në Parkun Kombëtar të Thethit, Valbonës etj.).

- Të thellohen studimet mbi ofertat e trashëgimisë sonë për të gjetur rrugët e menaxhimit dhe shfrytëzimit shkencor turistik në përputhje me prirjet e reja dhe kërkesat e sotme të industrisë turistike rajonale dhe botërore, si: turizmi i aventurës, speleologjik, i spektakleve biologjike etj. Studimet të fokusohen në përcaktimin e saktë të kapacitetit mbajtës të peizazheve të siteve të mbrojtura të ngarkesës turistike. Mbingarkesa do t'i shkatërronte ato.

- Studimet duhet të vazhdojnë dhe duhet të thellohen për të gjetur rrugët dhe mënyrat e mbrojtjes nga shkatërrimi galopant i vlerave dhe siteve të trashëgimisë sonë natyrore: ndërtime dhe projekte që do të dëmtojnë rëndë vlerat e Parkut Kombëtar Divjakë – Karavasta; zbatim i gabuar i projektit të rrugës dhe shëtitorës Pogradec – Lin; shkatërrimi i Parkut Kombëtar të Lurës; ndërtimi i centraleve hidroenergjetike në Parkun Kombëtar të Valbonës, Shebenik - Jablanicë etj.; mënyra të egra të shfrytëzimit turistik të monumenteve të natyrës (rasti i Plazhit të Gjeneralit etj.); prerje abuzive e pyjeve, gjuetia pa kriter; zjarre të qëllimshme, ndërtime kaotike jashtë rregullit urbanistik dhe shumë të tjera.

- Të vazhdojë puna për përgatitjen e planeve të menaxhimit për të gjitha zonat e mbrojtura. Këto plane duhet të jenë rezultat i punës studimore të specialistëve të natyrës dhe të shkencave humane, rezultat i konsultimeve me aktorët vendorë. Këto plane duhet të zgjidhin një nga detyrat themelore të menaxhimit efektiv të zonave të mbrojtura: sigurimin e partneritetit me popullsinë e zonave të mbrojtura ose përreth saj, e cila veç të tjerave, kërkon studime të detajuara sociologjike.

**Konferenca u bën thirrje të fuqishme të gjithëve për t'i njohur dhe për t'i mbrojtur këto thesare të mbetura të natyrës, të rrezikuara nga shkatërrimi dhe humbja përgjithmonë; për të ripërtërirë dhe rimëkëmbur sitet e dëmtuara dhe për t'i bërë ato të vizitueshme, duke i kthyer në gjeneratorë të fuqishëm të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.**